

QASJA *në* DREJTËSI

Secili banor i Kosovës gëzon të drejtën për mbrojtje të barabartë juridike dhe qasje të papenguar në drejtësi pa marrë parasysh etninë, gjuhën, gjininë, fenë, gjendjen ekonomike dhe sociale, aftësinë e kufizuar, orientimin seksual apo çfarëdo statusi tjetër.

Për t'i ushtruar këto të drejta, ju mund të:

KËRKONI AVOKAT

KËRKONI NDIHMË JURIDIKE FALAS

KËRKONI NDIHMËN E MBROJTËSIT TË VIKTIMAVE

PËRDORNI GJUHËN TUAJ

KËRKONI QASJE NË INFORMATA

KËRKONI AVOKAT

Ju gëzoni të drejtën në avokat në çdo kohë, që nga momenti i arrestimit nga policia deri në shpalljen e aktgjykimit të formës së prerë.

Nëse akuzoheni për kryerjen e një veprë të rëndë penale, si vrasje, përdhunim, krim seksual me të mitur dhe trafikim me qenie njerëzore, përfaqësimi nga avokati është i detyrueshëm. Për këto raste gjykata e ka për obligim që t'ju caktojë avokat me shpenzime publike, nëse ju vendosni që të mos angazhoni vet një të tillë.

Për të gjitha shkeljet tjera ju mund të kërkonti avokat me shpenzime publike dhe gjykata e merr vendimin në bazë të gjendjes tuaj financiare dhe veçorive të rastit tuaj.

Për më shumë informata, kontaktoni Odën e Avokatëve të Kosovës:
<http://www.oak-ks.org>
Numri i telefonit: 038 244 586

KËRKONI NDIHMË JURIDIKE FALAS

Ju gëzoni të drejtën në ndihmë juridike falas për çfarëdo procedure gjyqësore, nëse të ardhurat e familjes tuaj janë më të ulëta se paga mesatare, nëse merrni asistencë sociale ose nëse jeni në situatë të ngjashme me ata që marrin asistencë sociale.

Në bazë të kushteve të lartcekura, avokatët nga zyrat për ndihmë juridike falas dhe organizatat joqeveritare do t'ju përfaqësojnë falas në të gjitha rastet në gjykata.

Për më shumë informata vizitoni apo thërrisni:

Agjencinë për Ndhmë Juridike Falas (ANJF):
www.knj-rks.org Tel: 038 200 189 36

Qendrën për Ndhmë Juridike dhe Zhvillim Rajonal (CLARD): www.clardkosovo.org
Tel: 038 223 759

Programin për të Drejtat Civile në Kosovë (CRPK): www.crpkosovo.org
Tel: 038 243 610; 038 243 611; 038 243 612

Shoqatën e Juristëve NORMA:
www.norma-ks.org Tel: 038 249 778

Një projekt i financuar nga BE-ja për një burim tjetër të ofrimit të ndihmës juridike falas pritet të fillojë nëntor të vitit 2015.

Për më shumë informata në lidhje me projektin, ju lutem vizitoni: Pravna Pomoc
<http://www.pravnapomoc.org>

KËRKONI NDIHMËN E MBROJTËSIT TË VIKTIMAVE

Viktima është palë në procedurë në rastet penale. Mbrojtësi i viktimave mund t'i ndihmojë të gjitha viktimat, posaçërisht viktimat e dhunës në familje dhe të abuzimit seksual, trafikimit me qenie njerëzore dhe familjet e viktimave të vrara. Mbrojtësit e viktimave iu njoftojnë për të drejtat tuaja dhe i përfaqësojnë interesat tuaja.

Për më shumë informata se si të kërkonti ndihmë nga mbrojtësi i viktimave, ju lutem kontaktoni njërin nga zyrat e mbrojtësve të viktimave në kuadër të prokurorisë suaj themelore dhe thërrisni në linjën ndihmëse falas që është në dispozicion 24 orë: 080011112
Apo vizitoni <http://www.psh-ks.net>

PËRDORNI GJUHËN TUAJ

Nëse jeni të përfshirë në procedurë penale në gjykatë dhe nëse nuk e flisni gjuhën e procedurës, ju gëzoni të drejtën për të folur në gjuhën tuaj amtare dhe të drejtën për t'ju ofruar përkthim verbal dhe me shkrim falas.

Gjuha shqipe dhe ajo serbe janë gjuhë zyrtare në Kosovë. Gjykatat, prokuroritë dhe autoritetet tjera që janë të përfshira në procedurën penale duhet të sigurojnë që çdo person, i cili merr pjesë në çfarëdo procedure gjyqësore, mund ta përdor gjuhën zyrtare që ai ose ajo e zgjedh. Si palë, ju po ashtu e gëzoni të drejtën për të zgjedhur se në cilën gjuhë zyrtare do të zhvillohet procedura gjyqësore.

Për më shumë informata rreth të drejtës për përdorimin e gjuhës, kontaktoni Zyrën e Komisionerit për Gjuhët në numrin e telefonit 038 200 144 48 ose vizitoni www.komisioneri-ks.org.

KËRKONI QASJE NË INFORMATA

Ju mund ta vizitoni zyrën e shkrimores së gjykatës për çfarëdo që dëshironi të dini në lidhje me lëndën tuaj.

Në lëndët civile, kur pala e paditur mungon, gjykata e cakton një përfaqësues të përkohshëm për t'i përfaqësuar interesat e tij apo saj. Ky vendim i gjykatës botohet në tabelën e shpalljeve të gjykatës, në gazetën e përditshme dhe në Gazetën Zyrtare të Kosovës. <https://gzk.rks-gov.net>.

Nëse jetoni në njërin nga katër komunat veriore, pra në Mitrovicën Veriore, Leposaviq, Zvečan dhe Zubin Potok, atëherë këtë vendim të gjykatës tani mund ta gjeni edhe në tabelën e shpalljeve në stacionin e policisë.